



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 209/5 Prot

Tiranë, më 21 /02/2020

VENDIM

Nr. 04 , datë 21. 02.2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 209 Prot., datë 05.02.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës së datës 06.01.2020, depozituar në adresën elektronike të koordinatorit për të drejtën e informimit fludian.cuka@turizmi.gov.al, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me masat që janë marrë mbi shkeljet e bëra nga DRM – Fier për periudhën 2017-2018, si edhe një kopje të materialit të raportit të auditimit me konkluzionet përkatëse.

Autoriteti Publik, me emailin e datës 13.01.2020 i ka kthyer përgjigje kërkuarit duke refuzuar dhënien e informacionit me argumentin se: “Raporti përfundimtar i auditimit i është dërguar Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Fier dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Krahas raportit përfundimtar, janë dërguar edhe rekomandimet përkatëse, të cilat janë pranuar nga DRM – Fier dhe vazhdon zbatimi sipas afateve të lëna nga Auditimi. Mbështetur në nenin 3, pika 4, sqarojmë se neni 17 i ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e informimit” ka kufizime bazuar në gërmën c, konkretisht: Mbarëvajtja e procedurave

të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike. Sqarojmë se, përgjegjëse për masat e marra dhe afatet e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga Auditimi i brendshëm është DRM – Fier dhe AKM Tiranë.”

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, znj. _____ ka paraqitur ankimin nr. 209 Prot., datë 05.02.2020 pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, me Urdhrin nr. 29 datë 11.02.2020 vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që janë bërë pengesë për vënien në dispozicion të dokumentit të kërkuar.

Gjatë inspektimit koordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit Publik sqaroi se, pasi është vënë në dijeni për kërkesën e dërguar nga znj. _____ nëpërmjet *e-mail-it* të datës 06.01.2020, e ka dërguar për trajtim me *e-mail-in* e datës 08.01.2020 në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit si dhe në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm. Me datë 13.01.2020 kjo e fundit ka kthyer përgjigje, e cila i është dërguar kërkuases nëpërmjet komunikimit elektronik.

Grupi i inspektimit kërkoi të informohet nëse ky raport auditimi ka përfunduar dhe nëse disponohet nga autoriteti publik. Koordinatori sqaroi se nga komunikimi me *e-mail* me drejtorinë përkatëse, konstatohet se procesi ka përfunduar dhe ka filluar zbatimin e rekomandimeve të lëna. Gjithashtu, raporti përfundimtar i auditimit administrohet nga drejtoria e Auditit të Brendshëm pranë Ministrisë. Grupi i inspektimit kërkoi të mundësohet një takim me përfaqësues të kësaj drejtorie me qëllim rivlerësimin e qëndrimit të mbajtur për vënien në dispozicion të dokumentit të kërkuar. Ky takim nuk u realizua për shkak se në kohën e kryerjes së inspektimit, drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm nuk ndodhej në institucion.

Procesverbali u nënshkrua pa vërejtje nga ana e përfaqësuesit të Autoritetit Publik.

Pas konsultimit të legjisllacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, argumenti i parashtruar nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nuk qëndron.

Referuar përgjigjes së Autoritetit Publik se bazuar në gjermën ç), pika 2 e nenit 17, e drejta informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë në mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike, sqarojmë se ky kufizim ligjor nuk gjen zbatim në rastin konkret, pasi sikurse parashtron edhe përfaqësuesi i autoritetit publik gjatë inspektimit procesi i auditimit ka përfunduar dhe ka filluar zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Përsa më sipër, bazuar në paragrafin e dytë të pikës 2, të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” parashikon se kufizimi mbi të drejtën e informimit për shkak

të interesit të parashikuar në shkronjat “c” dhe “ç”, nuk zbatohet kur hetimi administrativ, në kuadër të një procedimi disiplinor dhe procedurat e inspektimit të auditimit të autoriteteve publike kanë përfunduar.

Gjithashtu, theksojmë se dokumenti objekt i kërkesës është akt përfundimtar i nxjerrë nga Autoriteti Publik dhe si rrjedhojë bazuar në pikën dh) të nenit 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, çdo autoritet publik vë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet *“mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit”*. Pra, informacioni i kërkuar bën pjesë në atë kategori informacioni, i cili duhet t’i vihet në dispozicion publikut pa kërkesë.

Nga ana e Autoritetit Publik, publikimi i raportit përfundimtar të auditit, duhet vënë në dispozicion të kërkuarit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i cili përcakton se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e znj. Aida Kristo ndaj Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’ i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Pranimin e ankesës nr. 209 Prot., datë 05.02.2020 të znj. _____, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/ dokumentacionit të kërkuar, në lidhje me *masat që janë marrë mbi shkeljet e bëra nga DRM – Fier për periudhën 2017-2018, si edhe një kopje të materialit të raportit të auditimit me konkluzionet përkatëse*, brenda datës 28.02.2020.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 21.02.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

